

SHËRBIMI PALIATIV

Në fushën e kujdesit paliativ është miratuar Ligji nr. 138, datë 16.10.2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”.

Janë miratuar 12 protokolle për kujdesin paliativ. Mjekët e familjes përshkruajnë të gjitha medikamentet e hormono-terapisë, që përfshihen tek ky kujdes. (Urdhër nr. 450, datë 24.10.2014, i Ministrisë së Shëndetësisë “Për miratimin e protokolleve klinike të kujdesit paliativ”)

Kemi garantuar shërbim afër vendbanimit për çdo pacient që vuan nga patologjitë e kancerit duke ofruar shërbimin paliativ në 11 spitalet tona rajonale, dhe shërbimin e kimioterapise ne 8 spitale rajonale.

Krahasuar me vitin 2013, ku rimbursohesh vetëm morfina dhe analgjezikët opioidë, sot rimbursohen: tramadoli, oksikodoni, fentanylli, duke e çuar nivelin e kujdesit në nivelet bashkëkohore. Ne listen e barnave që përdoren në kujdesin paliativ janë 92 barna me rimbursim, ku në Tiranë ky shërbim ofrohet nga QSH SOB dhe RYDER, gjithashtu në Durrës dhe Korçë nga RYDER dhe Qendra Mary Potter, kurse në rajonet e tjera ofrohet nga Mjeku i familjes.

QSH SOB Tiranë që ofron shërbime shëndetësore të kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike në stadi të avancuara dhe shumë të avancuara. në banesë për personat me banim të përhershëm.

Organizatat jofitimprurëse të licencuara që ofrojnë kujdes paliativ, Ryder Tirana dhe Durrës si dhe Mary Potter në Korçë.

Për rajonet që nuk ka ofrues privat të shërbimit paliativ, ndjekja dhe lëshimi i recetes bëhet nga mjeku i familjes.

Cdo spital ka ngritur dhe funksionon ky shërbim për pacientët, që kanë nevojë për kujdes paliativ me disa shtretër dhe personel shëndetësor që asiston pacientët. Barnat që nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, janë barnat e “listës esenciale” të kujdesit paliativ dhe sigurohen nga farmacia e Spitalit.

Fondi lidh kontrate me QSH SOB për financimin e shërbimeve shëndetësore të specializuara nga QSH- SOB në kujdesin shëndetësor parësor të rrethit të Tiranës, për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali deri në fund të jetës së tyre (kujdes paliativ).

Fondi lidh kontrate me organizatat jofitimprurëse Ryder për njohjen nga Fondi i së drejtës së lëshimit të recetes me rimbursim, nga mjeku i organizatës jofitimprurëse i certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ofrimin e kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali e në vazhdim.

Në qendrat SOB dhe Ryder (Tiranë, Korçë dhe Durrës) rimbursimi vjetor 2020 134 miliona leke, rimbursimi 2021 është 116 milionë leke viti 2022 104 miliona leke.

Vetëm për Shërbimin Onkologjik në Banesë vlera e rimbursimit të barnave esenciale të kujdesit paliativ në vitin 2020 119 milionë lekë, dhe ne 2021 103 milione leke, ne 2022 92 milione leke.

Në këto 5 vite në Listën e Barnave të Rimbursueshme kemi shtuar gamën e barnave për të sëmurët terminal, duke përfshirë tramadolin, oksikodonin dhe fentanylin, duke e çuar nivelin e kujdesit për pacientët terminal në nivelet bashkëkohore.